

## **NJOFTIM**

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, bazuar në Urdhërin Nr.90 datë 26.09.2023 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë:

**1 (një) personel akademik me angazhim kohë të plotë, për vitin akademik 2023-2024, kategoria lektorë ose asistent-lektorë pranë Departamentit të Shkencave Detare të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Pedagog me angazhim me kohë të plotë
- Mbështetje për nevojat e Departamentit dhe Fakultetit.

### **Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët**

- a) Të jetë shtetas/e shqiptar/e.
- b) Të zotëroj gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- c) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- d) Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- e) Të zotëroj aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- f) Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit etiko-profesionale me kolegët dhe eprorët;
- g) Të njohi një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të çertifikuara sipas testeve të njohura nga MASR. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje si dhe të mos jetë person nën hetim;
- i) Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna”;
- j) Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë;
- k) Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe autoriteteve/organeve drejtuese të saj, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

### **Kritere të veçanta**

1. Të ketë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në degën Navigacion ose Akademinë e Marinës në sistemin me kohë të plotë, të fituara në IAL në Shqipëri ose në universitete të huaja. Mesatarja mbi 8.0 përbën avantazh.

2. Të ketë përfunduar në sistemin me kohë të plotë Master i Shkencave në Fushën e Detarisë ose në degë të përafërta të fituara në IAL në Shqipëri ose në universitete të huaja.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata.

### **Kritere të tjera**

1. Cikli i Tretë i Studimeve ose Gradat Shkencore përbëjnë avantazh
2. Të zotrojnë aftësi profesionale për vendin e punës
3. Botime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit
4. Kurse Kualifikimi brenda dhe jashtë vendit
5. Njohuri të gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian
6. Për kandidatët e diplomuar në universitetet perëndimore dhe në universitete të tjera të huaja, diploma duhet të jetë njohur paraprakisht nga MAS. Konvertimi i notës mesatare sipas sistemit tonë të vlerësimit dhe përcaktimi i koeficientit të ponderimit të saj për efekt të kriterit bazë të përzgjedhjes. Koeficienti i ponderimit do të përcaktohet në varësi të nivelit të universitetit dhe të fushës së studimit.

### **Pikëzimi i kritereve**

<b>1. Pikëzimi për mesataren e notave fillon nga mesatarja bazë e vendosur si kriter</b>	
Për të dyja ciklet e studimit	0.50 pikë për çdo 1/10 e notës duke filluar nga mesatarja e vendosur si kriter
Doktoraturë e përfunduar	20 pikë
Profesor i asociuar	25 pikë
Profesor	30 pikë
<b>2. Aktivitet Shkencor</b>	
<b>Artikuj</b>	
- Artikuj të botuar në revista me bord editorial dhe ISBN	1 pikë për çdo artikull
- Artikuj të botuar në revista me Faktor Impakti	2 pikë për çdo artikull
<b>Konferenca Shkencore</b>	
- Pjesëmarrje në konferenca kombëtare ku punimi është botuar në procesing me bord editorial, me ISBN	1 pikë për çdo konferencë
- Pjesëmarrje në konferenca	2 pikë për çdo konferencë

ndërkombëtare në vendet e BE, ku punimi është botuar në procesing me bord editorial, me ISBN	
<b>Gjuhë e huaj</b>	2 pikë

### Dokumentacioni i kërkuar

- a) Formular i aplikimit i plotësuar nga aplikanti.(formulari i aplikimit gjendet në adresën [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)).
- b) Jetëshkrim/ Curriculum Vitae;
- c) Diploma/t universitare (kopje e noterizuar);
- d) Lista e notave të studimeve universitare (origjinal);
- e) Tituj akademik ose grada shkencore (kopje e noterizuar);
- f) Dëshmi të kualifikimeve trajnimeve apo specializimeve (kopje e noterizuar);
- g) Artikuj të botuar, projekte shkencore, etj;
- h) Libreza e punës ose vërtetim zyrtar për periudhën kohore të punësimit nga organi tatimor, nëse ka vjetërsi pune (origjinal ose kopje të noterizuar);
- i) Dy rekomandime nga profesor/profesor i asociuar ose/dhe punëdhënësi i fundit;
- j) Referenca që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
- k) Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj (origjinal ose kopje e noterizuar);
- l) Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);
- m) Vërtetim i gjëndjes gjyqësore (dokument i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku kandidati ka vendbanimin);
- n) Letërnjoftimi ID (fotokopje e kartës së identitetit);

#### Shënim:

*Diplomat, certifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me certifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".*

### Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:



Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore.

**Aplikim për punësim/pozicioni i punës:** *"Personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Shkencave Detare në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore*

Lagjia "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë, Shqipëri.

## **Afati për aplikim**

- ✓ Afati për të aplikuar është 10 ditë kalendarike. Ky afat fillon nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të internetit të UV-së. (njoftimi u publikua në datën 27.09.2023 dhe afati përfundon në datën 06.10.2023).
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 06.10.2023, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.

## **Fazat në të cilën do të kalojë konkurimi**

- ✓ Konkurimi do të kryhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista e drejtëpërdrejtë e kandidatit.
  - vlerësimi i dosjes parashikon verifikimin e dokumentave nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin vakant, vlerësimin e arsimimit, përvojës në punë, trajnimet e kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe vlerësimet pozitive;
  - intervista e strukturuar me gojë;

## **Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë**

- Aftësitë komunikuese dhe profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron, aftësitë e punës në grup, etj.

## **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve, është si më poshtë vijon:

- 70 pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, e ndarë në: 30 pikë arsimimi, 20 pikë përvojë në mësimdhënie, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.
- 30 pikë intervista e strukturuar me gojë, ku, me një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe formimi i tyre.

## **Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

Komunikimi dhe njoftimi i kandidatëve do të mundësohet nga zyra e burimeve njerëzore të UV-së nëpërmjet postës elektronike.

**DREJTOR**

**Eloina TOZAJ**